



Në bazë të nenit 64 pika 1 e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publikë të Republikës së Kosovës, në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit administrativ nr. 34/2014 funksionimi i shërbimit pedagogjik – psikologjik në shkolla, Drejtorati për Arsim në Drenas, shpallë:

## K O N K U R S

### 1. SHFMU” Luigj Gurakuqi ” në Sankoc

- Një mësimdhënës/e për TIK me 18 orë, prej tyre 10 orë në SHFMU” Luigj Gurakuqi ” në Sankoc + 4 orë në SHFMU” 24 Korriku” në Fushticë e Poshtme + 4 orë në SHFMU” Fehmi dhe Islam Kastrati “ në Kishnarekë, deri sa të kthehet zyrtari nga detyra zyrtare.

### 2. SHFMU” Abedin Bujupi ” në Arllat

- Një mësimdhënës/e për Biologji, më kohë të pacaktuar.

### 3. SHFMU” Shaban Polluzha ” në Polluzhë

- Një mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.

### 4. SHFMU” Mehmet Gradica ” në Gradicë

- Një mësimdhënës/e për Matematikë, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.

### 5. SHFMU” Bajram Curri ” në Nekoc

- Një pedagog/e, si dhe në SHFMU”Rilindja” në Dobrashevc, më kohë të pacaktuar

### 6. IAAP ,, Fehmi Lladrovci ” në Drenas.

- Një mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze me 12 orë, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit të lehonisë.

## KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.05 / 2021 – MASHTI, 34/2014 – MASHT.

## DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit ( letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma ose Çertifikata e diplomimit- jo më e vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik.
4. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më e vjetër së gjashtë muaj.
5. Vërtetim i përvojës së punës vetëm në arsim (nëse keni).
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur më çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.
7. Kopje të Çertifikatave të trajnimeve përkatëse ( nëse keni)

## **REKRUTIMI:**

Intervistat me shkrim më gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do ta bëjë Komisioni i përzgjedhur nga DKA.

## **VËREJTJE:**

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-së, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit, dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurrimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

**Drenas,**

**Më:30.01.2023**

  
Drejtor për Arsim  
**Muhamet Gjoka**